



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

V E N D I M
Nr. 75, datë 01.07.2024

**PËR SHPALLJEN E KANDIDATIT FITUES TË ZGJEDHJEVE
PËR POZICIONIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika 7, dhe neni 39; Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020, neni 39; si dhe mbi rezultatin përfundimtar të votimeve në të gjitha njësitë e Universitetit të Tiranës, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UT-së:

V E N D O S I

1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për pozicionin e Rektorit të Universitetit të Tiranës:

Prof. Dr. Artan Nexhdet Hoxha
me rezultatin e votave “Pro”: 89,22% (tetëdhjetë e nëntë presje njëzet e dy përqind).

2. Bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, kandidati Prof. Dr. Artan Nexhdet Hoxha shpallet fitues për pozicionin e Rektorit të Universitetit të Tiranës.
3. Ky Vendim i KIZ-it të UT-së hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve në përputhje me Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020.
4. Ky Vendim publikohet në këndin zgjedhor të UT-së dhe në faqen elektronike zyrtare të UT-së, si edhe në këndet zgjedhore të njësisë kryesore të UT-së dhe në faqet elektronike zyrtare të të gjitha njësisë kryesore të UT-së dhe Filialit të Sarandës.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Leticja Gusho | (Kryetar) |
| 2. Arjan Tushaj | (Anëtar) |
| 3. Alnida Koroshi | -//- |
| 4. Eljon Doçe | -//- |
| 5. Etlon Peppo | -//- |
| 6. Shaniko Allajbeu | -//- |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- |

